

LIGJ
Nr.9986, datë 11.9.2008

PËR FALJEN E DETYRIMEVE DOGANORE DHE TATIMORE, TË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË TAKSËS VJETORE TË QARKULLIMIT RRUGOR TË MJETEVE E TË TAKSËS SË REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE, SI DHE TË GJOBAVE E KAMATËVONESAVE TË PAPAGUARA TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE TË DETYRUESHME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
FALJA E DETYRIMEVE TATIMORE DHE DOGANORE

Neni 1

Personave fizikë e juridikë, që janë debitorë ndaj administratës doganore dhe administratës tatimore, të evidentuar dhe të kontabilizuar pa vendime administrative përkatëse apo me vendime administrative të panjofuara brenda afateve ligjore, të parashikuara në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin për procedurat tatimore, u falet detyrimi doganor dhe tatimor, së bashku me komponentët, gjobat dhe kamatëvonesat.

Neni 2

Personave fizikë e juridikë, debitorë ndaj administratës doganore dhe administratës tatimore, që janë aktualisht të evidentuar dhe të kontabilizuar si të tillë në këto dy administrata, për të cilët procedura e evidentimit, marrjes së vendimit administrativ përkatës, si dhe njoftimit të tij debitorit është bërë në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit për procedurat tatimore, u falen gjobat dhe kamatëvonesat, me kusht që principlali i detyrimit të paguhet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 3

1. Personave fizikë, individë, debitorë ndaj administratës doganore, për automjetet e importuara, të evidentuara dhe të kontabilizuara deri në datën 31.12.2000, u falet detyrimi doganor, me të gjithë komponentët e tij, si kamatëvonesa, gjoba dhe ditë-qëndrimi.

2. Personave fizikë e juridikë, debitorë ndaj administratës doganore, për automjetet e importuara, të evidentuara dhe të kontabilizuara nga data 1.1.2001 deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, u falen kamatëvonesat, gjobat dhe taksa për ditë-qëndrimi, me kusht që principlali i detyrimit të arkëtohet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 4

Institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve e shoqërive me kapital tërësisht shtetëror, debitorë ndaj administratës doganore dhe administratës tatimore, u falen detyrimi doganor dhe detyrimi tatimor, me të gjithë komponentët, si kamatëvonesa dhe gjoba.

KREU II
FALJA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË TAKSËS VJETORE TË QARKULLIMIT
RRUGOR TË MJETEVE DHE TË TAKSËS SË REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË
MJETEVE

Neni 5

Taksapaguesve të mjeteve rrugore, debitorë ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për taksën vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe debitorë ndaj njërive të qeverisjes vendore, për taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, u falen detyrimet e prapambetura me kusht që:

a) pronarët e mjeteve, që nuk janë në qarkullim, të kenë kryer, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, veprimet përkatëse të çregjistrimit, sipas nenit 102 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pronarët e mjeteve, që janë në qarkullim, të kenë kryer, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, veprimet përkatëse të pagesës së detyrimeve, me të gjithë komponentët, për vitin 2008, sipas ligjit nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9632, datë 15.12.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

KREU III
FALJA E GJOBAVE DHE KAMATËVONESAVE TË PAPAGUARA TË KONTRIBUTEVE
TË SIGURIMEVE TË DETYRUESHME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Neni 6

1. Ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital tërësisht shtetëror, institucioneve shtetërore, buxhetore e jobuxhetore, ndërmarrjeve e shoqërive me kapital të përbashkët me shtetin, personave juridikë e fizikë privatë u falen gjodat dhe kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që principli i kontributit të paguhet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Personave fizikë të vetëpunësuar, të cilët e kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike përpara datës 31.12.2005 dhe që janë debitorë, të evidentuar dhe të kontabilizuar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, u falen të gjitha detyrimet e papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, gjodat dhe kamatëvonesat.

3. Personave të vetëpunësuar në bujqësi u falen gjodat dhe kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të papaguara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që principlin e kontributit ta paguajnë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Gjodat dhe kamatëvonesat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

KREU IV
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 7

Individët, personat fizikë dhe juridikë, debitorë ndaj administratës doganore e tatimore dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për të cilët ka filluar një procedim penal dhe që në përfundim të tij deklarohen fajtorë, apo detyrimi i të cilëve është përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ose që e kanë paguar detyrimin, me të gjithë komponentët e tij, nuk janë përfitues të faljes së detyrimeve, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 8

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë aktet nënligjore për kontabilizimin e të ardhurave, të mbledhura në përputhje me nenet 2, 3, 4 e 6 të këtij ligji dhe për sistemimin e detyrimeve të papaguara të subjekteve debitore në një llogari kontabël “Detyrimi i keq”.

Neni 9

1. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Krugor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe njësitë e qeverisjes vendore për sistemimin e detyrimeve të prapambetura, sipas nenit 5 të këtij ligji.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5890, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**